

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Mbi 414 kg hashash me vlerë mbi 4 milionë euro, arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali
ADRESA	https://tpz.al/video-mbi-414-kg-hashash-me-vlere-mbi-4-milione-euro-arrestohet-29-vjecar-i-shqiptar-ne-itali-i333324
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 08:06:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 07:58:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	abae3838a6efdb6bacabbe0cb0e63c6bf02816cc3d9b6d81d8aed1e0f77007a1
TEKSTI	56b168672d1b0da3ea3b81868a8e2439c843f163d43126da8877fb8aa0d5dc30
PAMJA	8868963ec866959bbf5a8103414e065dc9c03bc393e62ad84c4cfd999c55b227

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0e314baece6fb4d0e5dcc08f5572b5f3e286ad7a6fcc9cf8eed35af44a5f12c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2efc04bea43acf0f6a2e38be2863702e338fd789cd0cf3c1cc14a88f36ac9872
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0e314baece6fb4d0e5dcc08f5572b5f3e286ad7a6fcc9cf8eed35af44a5f12c8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

18:56 Erion Veliaj thyen këmbën duke luajtur futboll në paraburgim, dërgohet në spital • 18:10 "Shuplakë" Serbisë dhe Bosnjes, presidentja e KE vizitë në Shqipëri, Kosovë, M

AKTUALITET, 19 SEPTEMBER 2026, 09:58

VIDEO/ Mbi 414 kg hashash me vlerë mbi 4 milionë euro, arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali

tpz.al TPZ



Një 29-vjeçar me origjinë shqiptare është arrestuar në Guidonia Montecelio, pranë Romës, pasi policia italiane zbuloi mbi 414 kilogramë hashash në automjet dhe në disa ambiente të përdorura si depo. Droga, sipas autoriteteve, do të mund të gjeneronte mbi 4 milionë euro nëse do të hidhej në tregun me pakicë.

Operacioni u zhvillua nga hetuesit e Seksionit VII të Antidrogës së Squadra Mobile të Romës, të cilët kishin vënë nën vëzhgim lëvizjet e 29-vjeçarit në zonën e Guidonia-s.

I riu u pikas pranë një objekti teksa po përpiqej të ngarkonte në bagazhin e makinës disa valixhe të mëdha. Pësia e tyre dhe mënyra se si po përpiqej t'i ngarkonte tërhoqën vëmendjen e policëve.

Kontrolli i automjetit zbuloi brenda valixheve rreth 98 kilogramë hashash, të ndarë në pako.

Por hetimi nuk u ndal me kaq. Gjatë kontrollit, policia i gjeti të riut edhe një tufë çelësash. Ato rezultuan të ishin çelësa për disa ambiente në Guidonia dhe zona të ndryshme të Romës.

Çelësat çuan hetuesit drejt një rrjeti të mirëorganizuar ambientesh që dyshohet se përdorshin për ruajtjen dhe përgatitjen e drogës.

Në këto ambiente u gjetën sasi të tjera të mëdha hashashi, si dhe materiale që dyshohet se përdorshin për paketimin e lëndës narkotike.

Një nga detajet më të veçanta të operacionit ishte mënyra e ruajtjes së një pjese të drogës. Hashashi ishte vendosur brenda frigoriferëve, të cilët ishin përshtatur dhe përdorshin si ambiente të posaçme për stoqimin e lëndës narkotike.

Përveç drogës dhe materialeve të paketimit, policia gjeti edhe shënime të shkruara me dorë, me shifra, të dhëna dhe llogaritje që dyshohet se lidhen me sasitë e drogës së lëvizur dhe shpërndarjet.

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejko

[Shiko të tjera video](#)

Kontrollet u shtrinë edhe në një garazh në dispozicion të 29-vjeçarit, ku u gjetën materiale të tjera që dyshohet se shërbenin për përgatitjen dhe paketimin e dozave.


Në përfundim të operacionit, sasia totale e hashashit të sekuestruar arriti në mbi 414 kilogramë.

Sipas përlogaritjeve të autoriteteve italiane, nëse kjo sasi do të hidhej në tregun me pakicë, vlera e fitimeve të paligjshme mund të kalonte 4 milionë euro.

29-vjeçari u arrestua nën dyshimin për posedim të lëndëve narkotike me qëllim trafikimin.

Autoriteti gjyqësor më pas ka konfirmuar arrestimin dhe ka vendosur ndaj tij masën e arrestit në burg.

Autoritetet italiane theksojnë se bëhet fjalë për një fazë hetimore dhe se ndaj të arrestuarit zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë deri në një vendim përfundimtar të formës së prerë.



AKTUALITET / 19 September 2026, 09:40

Alket Rizai ende në arrati, emri i tij del në një tjetër vrasje në burgun grek! Kamerat e sigurisë e çojnë në vendin e krimit

AKTUALITET / 19 September 2026, 09:12

"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle

AKTUALITET / 18 September 2026, 22:59

Kush ishte 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas për vdekje nga kamioni i plehrave para syve të së bijës 9-vjeçare

AKTUALITET / 18 September 2026, 22:32

Ambasadorja e BE-së takon Gogun: Besimi i publikut te drejtësia, thelbësor për të ardhmen e Shqipërisë në BE

AKTUALITET / 18 September 2026, 21:09

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

AKTUALITET / 18 September 2026, 20:27

Aksidenti në Athinë, dalin fotot, këta janë tre të rinjtë që humbën jetën tragjikisht

AKTUALITET / 18 September 2026, 20:23

111 ditë protestë kundër qeverisë, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit: Rama, jepe dorëheqjen!

AKTUALITET / 18 September 2026, 20:17

Meta nën hetim pas pezullimit të llogarive që postonin mbi protestat në Shqipëri, eurodeputetët: Është censurë!

AKTUALITET / 18 September 2026, 20:10

Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë në gjendje kritike

AKTUALITET / 18 September 2026, 19:29

Takimi sekret në Buenos Aires - Mediat uruguaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon!

AKTUALITET / 18 September 2026, 18:56

Erion Veliaj thyen këmbën duke luajtur futboll në paraburgim, dërgohet në spital

AKTUALITET / 18 September 2026, 18:10

"Shuplakë" Serbisë dhe Bosnjes, presidentja e KE vizitë në Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe RMV

AKTUALITET / 18 September 2026, 18:02

E rëndë në Skrapar! Foshnja transportohet drejt Traumës, dyshohet se ka dëmtuar dorën me grirëse mishi

AKTUALITET / 18 September 2026, 17:52

"Ministria e Financave, çelësi i anëtarësimit në BE", ambasadorja Moreira de Sousa takon ministrin Malaj

AKTUALITET / 18 September 2026, 17:47

Ku shkon kredia e bizneseve? Burrat e kërkojnë për investime, gratë sipërmarrëse për kapital qarkullues

AKTUALITET / 18 September 2026, 17:34

Prodhimi i energjisë, Karakaçi: Fotovoltaikët prodhuan 30% të energjisë në qershor

AKTUALITET / 18 September 2026, 17:22

Risi në zhdoganimin e automjeteve, Dogana miraton manualin: Ja si do të llogaritet vlera e makinave

AKTUALITET / 18 September 2026, 17:00

Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firenze, hajdutët i vjedhin lejen e qëndrimit dhe sende me vlerë 30 mijë euro! Nipi: Ja çfarë më tha kur e njoftova

AKTUALITET / 18 September 2026, 16:32

Ministri Hoxha diskuton me përfaqësuesin e ri të OBSH-së: Bashkëpunim për një shërbim shëndetësor më të zhvilluar

AKTUALITET / 18 September 2026, 16:11

PD propozon tre projektligje për kontrollin e fondeve publike: Duhet gjurmim i parave që përdor privati

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

NJOFTIME NGA TPZ.AL 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET

IDE

NË FOKUS

BALLKAN

BOTA

LIFESTYLE

SPORT

TEJ E KETEJ

BLOG

EMISIONE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.